

Rishikimi i TSHV 2013-2017

PYETËSORI I KEK-ut – Shënime udhëzuese

Të përgjithshme

Butoni “RETURN” në secilin fletë dërgon shfrytëzuesin në fletën naviguese.

Fleta shfrytëzon macros dhe kështu që këto duhet të mundësohen në mënyrë që funksioni i përkthimit të funksionoj.

Fleta mund të shikohet në gjuhën shqipe dhe angleze duke i përdorur butonat e përzgjedhur në fletën naviguese.

Fletat janë të mbrojtura për të parandaluar fshirjen aksidentale të formulës – nuk ka ndonjë fjalëkalim të vendosur ashtu që fleta mund të jetë të pambrojtur për të shtuar informata shtesë po që se kjo nevojitet.

Secila informatë shtesë mund të sigurohet si dokument mbështetës.

Të gjitha vlerat monetare duhet të jenë në € 000's.

Aty ku kompania nuk i ruan informatat e kërkuara në nivelin e kërkuar ju lutemi t'i shfrytëzoni përpjekjet më të mira të vlerësoni përpjesëtimin e vlerave të njohura nëpër nënkategoritë e kërkuara dhe të ofroni dokumentacion mbështetës për të shpjeguar vlerësimin dhe alokimin e përdorur.

Udhëzimi specifik për fletën

HQ1 – Kostot operative në këtë fletë janë vetëm ato kosto që i janë alokuar Selisë kryesore dhe si pasojë do t'i përpjesëtohen të licencuarve përkatës.

HQ2 – Alokimi aktual i kostove operative të Selisë kryesore në vitin 2011.

HQ3 – Alokimi i pritur i kostove operative të Selisë kryesore në vitin 2013.

HQ4 – Numri i stafit në secilin divizion i ndarë sipas llojit të kualifikimit.

HQ5 – Kjo kërkon të hyrat e përgjithshme për Grupin, të ndara sipas secilit të licencuar/divizion. Kategoria e të hyrave përputhet me llogaritë statutores; është e qartë se jo të gjitha kategoritë zbatohen për secilën divizion dhe se këto të hyra do të jenë zero. Secila e hyrë që nuk është në gjendje t'i alokohet

direkt të licencuarit duhet të futet në Selinë kryesore dhe të ofrohet një lloj shpjegimi për llojin e të hyrave dhe arsyen se pse nuk mund të alokohet.

HQ6 – Këto pyetje narrative duhet të gjejnë përgjigjen sa më të plotë të mundshme në një dokument plotësues dhe në secilin dokument mbështetës të ofruar.

DS1 – Kostot e Mirëmbajtjes dhe Riparimit duhet të futen në përputhje me kostot që do të shfaqeshin në llogaritë e shthurura. Kuptohet se hollësitat në këtë fletë nuk ruhen në sistemin e kontabilitetit dhe nga kompania kërkohet që t'i vlerësoj nivelet e shpenzimeve duke përpjesëtuar shifrën e përgjithshme duke i shfrytëzuar vlerësimet dhe njohuritë më të mirë të volumit aktual të punës të cilat mbliidhen për DS2.

DS2 – Raportimi i brendshëm i performancës së Mirëmbajtjes dhe Riparimit duhet të përdoret për të ofruar volumet vjetore për secilin lloj të mirëmbajtjes dhe prishjeve që regjistrohet. Informatat historike kërkohen vetëm për raportet që ekzistojnë. Ju lutem ofroni një ekzemplar të raporteve mujore dhe vjetore të brendshme të paraqitura. Ju lutem ofroni një ndarje të hollësishme.

DS3 – Kostot operative duhet të raportohen në përputhje me ndarjen e ofruar të kontabilitetit, dhe parashikimet duhet të jenë vlerësimet më të mira të kompanisë. Shpenzimet kapitale të kërkuara janë shpenzimet që nuk janë pjesë e planit të përgjithshëm të rrjetit të investimit; (kjo do të kapet në DS5 dhe DS6). Kërkohen vetëm informatat për projektet që aktualisht janë në vazhdim e sipër dhe projektet e ardhshme me shpenzime në periudhën TSHV.

DS4 – Ju lutemi futni numrat e stafit në secilin departament. Aty ku departamentet ndryshojnë nga ato të shënuara ju lutemi t'i shtoni emrat e departamentit në tabelë dhe t'i plotësoni informatat.

DS5 – Përdorni një linjë të veçantë për secilin rrejt të Programit të projektit të punëve në planin e investimit. Kërkohen vetëm informatat për projektet që aktualisht janë në vazhdim e sipër dhe projektet e ardhshme me shpenzime në periudhën TSHV. Projektet me shpenzime në vitet paraprake që kanë përfunduar para vitit 2012 nuk kërkohen. Projektet në lidhje me ngarkesën dhe zëvendësimin e aseteve janë vetëm për shpenzimet e aseteve të rrjetit elektrik. Projektet duhet të klasifikohen në lidhje me ngarkesën ku shpenzimet drejtohen me rritjen e kërkesës, projektet e Zëvendësimit të Aseteve drejtohen me zëvendësimin e jetëgjatësisë apo kushtit. Cilësia e projekteve të furnizimit janë projekte të rrjetit të cilat kanë të bëjnë kryesisht në përmirësimin e performancës së rrjetit për konsumatorë. Projektet operative mbulojnë sistemet ndihmëse, komunikimin dhe projektet e rrjetit të TI-së. Shumë nga projektet do të kenë një përzierje të asaj më lartë. Ju lutemi specifikoni projektin duke u bazuar në arsyen kryesore për ndërmarrjen e projektit.

DS6 – Kjo është një hollësi e parashikimit sipas vitit sipas rrjedhës së parasë së projektit.

DS7 – Kyçjet të cilat i instalon KEK-u janë ato kyçje ku KEK-u ofron shërbime të plota dhe se konsumatori e paguan kontributin për asetet e instaluar. Vlera e Asetit duhet të jetë kostoja totale e asetëve të instaluar. Diferenca në mes të vlerës së asetëve të instaluar dhe kontributeve të konsumatorit do të jetë vlera që i alokohet bazës së asetit rregullativ. Për kyçjet e instaluar të konsumatorëve ku asetet e

instaluara nga konsumatori transferohen në KEK në zotërim dhe për mirëmbajtje atëherë ju lutemi ofroni vlerën e vlerësuar të këtyre asetëve dhe çfarëdo pagese që i ben KEK-u për asetet apo çfarëdo kontributi që ben konsumatori për asetet që instalohen nga KEK-u për kyçje.

DS8 - Për secilin lloj të asetit që e ka KEK-u, ju lutem shënoni 'jetëgjatësinë teknike' që KEK do t'i përdorte për të përcaktuar kërkesat e zëvendësimit. Ju lutemi cekeni numrin/kohëzgjatjen e përgjithshme të secilit lloj të asetit dhe plotësojeni kufirin e jetëgjatësisë së asetit të rrjetit duke dhënë hollësira për periudhën e instalimit për asetet. Disa asete mund të kenë regjistrime të sakta p.sh. Transformatorët kryesor dhe disa mund të mos kenë p.sh kabllot. Aty ku profili i jetëgjatësisë nuk dihet, ju lutemi ofroni një vlerësim sipas një paragjykimi të inxhinierit dhe profileve të njohura të asetit. Ju lutem shpjegoni çfarëdo vlerësimi të përdorur.

DS9 – Ashtu siç njihet DS8.

DS10 – Ju lutem futeni koston aktuale të artikullit të cilat do t'i priste KEK-u për secilin prej llojeve të asetëve. Ju lutemi ofroni një shpjegim të cilitdo supozim të bërë p.sh. Madhësia e transformatorit apo madhësia e kabllot dhe nëse kostoja përfshin rrjetin njëfazor apo dy fazor apo kostot e nxjerrjes.

DS11 – Nuk ka udhëzime tjera.

DS12 – Nëse rajonet e minoriteteve nuk dihen lëreni të zbrazët.

DS13 – Nuk ka udhëzime tjera.

DS14 – Ju lutemi shpjegoni kriteret për të përzgjedhur linjat me performancë më të dobët.

DS 15 – Kjo fletë nuk kërkon input.

PS1 – Si DS4.

PS2 – Ju lutemi ofroni një vlerësim të kostove me të cilat ofrohet qendra e thirrjeve dhe funksioneve të qendrës kontaktuese, numri mesatar i stafit dhe ndarja e kostove në mes të shërbimeve të ofruara për të licencuarit e veçantë.

PS2a – Nuk ka udhëzime tjera.

PS3 - Kërkohen vetëm informatat për projektet që aktualisht janë në vazhdim e sipër dhe projektet e ardhshme me shpenzime në periudhën TSHV. Projektet me shpenzime në vitet paraprake që janë përfunduar para vitit 2012 nuk kërkohen.

PS4 – Qendra e thirrjeve dhe informatat e qendrës kontaktuese kërkojnë një numër të thirrjeve apo vizitave të konsumatorëve në lidhje më secilën prej arsyeve në këtë fletë. Për shembull: numri i pyetjeve për pagesat që janë trajtuar apo aplikacioni për kyçje të reja. Ju lutemi plotësojeni, për bilancin e energjisë, elementet ku KEK-u i mban të dhënat origjinale me parashikimet e juaja më të përditësuara. Çfarëdo difference nga ajo e bilancit të fundit të dërguar të aprovuar të energjisë duhet të shpjegohet.

PS5 – Kjo fletë nuk kërkon input.

PT1 – Si DS4

PT1a – Si DS3

PT 2 - Kjo fletë nuk kërkon input.

MN1 – Si DS1

MN2 – Nuk ka udhëzime tjera.

MN3 – Për sektorin Capex (shpenzimet kapitale), kërkohen vetëm informatat për projektet që aktualisht janë në vazhdim e sipër dhe projektet e ardhshme me shpenzime në periudhën TSHV. Projektet me shpenzime në vitet paraprake që janë përfunduar para vitit 2012 nuk kërkohen.

MN4 – Përdorni një linjë të veçantë për secilin projekt në planin e investimit. Kërkohen vetëm informatat për projektet që aktualisht janë në vazhdim e sipër dhe projektet e ardhshme me shpenzime në periudhën TSHV. Projektet me shpenzime në vitet paraprake që janë përfunduar para vitit 2012 nuk kërkohen.

MN5 – Si DS6

MN6 – Për secilin lloj të asetit, plotësojeni kufirin e jetëgjatësisë së asetit duke dhënë hollësi për periudhën e instalimit për asete. Disa asete mund të kenë regjistrime të sakta e disa jo. Aty ku profili i jetëgjatësisë nuk dihet, ju lutemi ofroni një vlerësim sipas një paragjykimi të inxhinierit dhe profileve të njohura të asetit.

MN7 – Nuk kërkohet input.

Për gjenerim, aty ku kostot për KOSOVËN A dhe B nuk mund të ndahen dhe ku nuk është e nevojshme të futen shifrat e përgjithshme, ju lutemi ofroni hollësitat e secilit supozim të përdorur.

GN1 – Si DS4

GN2 – Si DS4

GN2a – Si DS3

GN3 – Nuk ka udhëzim tjetër

GN4 – Nuk ka udhëzim tjetër

GN5 - Si MN 4

GN6 – Si DS6

GN7 – Si MN6

GN8 – Kjo fletë kërkon që të hyrat që janë futur për Gjenerim në HQ5 duhet të ndahen për Kosovën A dhe B.